

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

BLERINA HARIZAJ

RUBAIA NË POEZINË SHQIPE

Në historinë e zhvillimit të saj, letërsia shqipe ashtu si letërsitë e tjera botërore, ka qenë e hapur për marrëdhënie me sistemet e tjera letrare. Letërsia shqipe, si një letërsi periferike ka huazuar prej këtyre sistemeve burimore: modele, tema apo edhe lloje poetike dhe i ka bërë pjesë të saj, duke ruajtur gjithmonë identitetin e vet origjinal. Për të përligjur çfarë thamë më sipër, shembulli më tipik është ai i huazimit të llojit poetik persian, rubaisë, nga poetët shqiptarë të ditëve të sotme. Rubaia është një poemë e shkurtër e përbërë prej katër vargjes, që rimon sipas skemës aaba apo aaaa, e cila ka pavarësinë e vet, duke na pohuar një të vërtetë morale apo edhe filozofike. Kjo formë poetike pati një përdorim të gjerë në letërsinë sufite, e cila u zhvillua krahas formave të tjera poetike si: masnavia dhe gazali. Po të hedhim një vështrim retrospektiv, rubaia u bë e njohur për lexuesin shqiptar përmes përkthimit gjenial të “Rubairave”, të Omar Khajamit nga Fan Noli në vitin 1926, dhe dijetarit të shquar Hafiz Ali Korça, “Katrorët e Umar Khajamit” në vitin 1942. Më pas do të huazohej nga poetët shqiptarë, të cilët shkruan vepra nën ndikimin e këtij zhanri poetik. Midis poetëve që e huazuan këtë lloj poetik si: Dritëro Agolli, Dhori Qirjazi, Nexhip Ejupi, Jorgo Lipe, Agim Shehu, Nijazi Sulçe etj., disa nga të cilët i kanë qëndruar besnikë këtij zhanri si në formë dhe përmbajtje, do të veçojmë si më interesantin, poetin Habib Skënderi. Në krijimtarinë letrare të këtij të fundit numërohen 7 vëllime me rubairat, ku përmendim; “Njëmijë rubairat, pres”, “Unë do të pres rubairat,” “Rubairat shqiptare, pres”, “Kur je duke pritur, rubairat”, “Rubairat shqiptare, ku po vemi?”, “Të pres” poezi dhe “Gjithnjë pres”, poezi. Në këto vepra duket qartë aftësia poetike e shkrimtarit Skënderi për ta sjellë rubainë në formën e saj origjinale. Ajo që na shtyn që ta pranojmë këtë fakt, është pikërisht skema metrike e rubaisë, aaba dhe aaaa, që është përdorur më shumë nga gjithë skemat metrike të tjera, siç janë të katrenit klasik. Përdorimi i tij nga ana e poetit nuk është i rastësishëm, sepse po t’i referohemi enciklopedisë së poezisë dhe poetikës së Princeton, citohet, “Katreni është forma e rubaisë iraniane”¹. Sipas përkufizimit teorik të mësipërm, rubaia në vetvete është një katren (katërvargësh). Dhe, kjo justifikon përdorimin, pothuajse të të gjithë skemave metrike të katrenit nga ana e poetit Habib Skënderi në rubairat e tij. Para se të analizojmë vargun e poetit, një çështje me rëndësi që duhet trajtuar, është edhe ajo e huazimit të modelit poetik persian rubaisë në letërsinë shqipe. Ndër studiuesit që e ka trajtuar më thellë dukurinë e huazimit mes letërsive të ndryshme është Itamar Zohar, i cili i shikon letërsitë në marrëdhënie

¹ S. Cushman, C. Cavanagh, J. Ramazani, P. Rouzer, R. Greene, *The Princeton encyclopedia of poetry and poetics*, vol 4, 2012, f. 1138.

interferenciale. Zohar kur flet për dukurinë e interferencës, ka parasysh “marrëdhënien mes letërsive, me anë të të cilit një filan letërsi A (letërsia burimore) mund të bëhet një burim i huazimeve direkte apo indirekte për një tjetër letërsi B (letërsi target, ose letërsi e shenjuar).”² Gjithashtu, ai ndër të tjera flet edhe për rrugët (apo kanalet siç i quan ai) e vendosjes së kontakteve letrare mes vendeve të ndryshme, ku ndër to veçojmë përkthimin:

“Kanalet përmes të cilave ndodhin kontaktet letrare, dhe që shkaktojnë migrimin e elementëve janë disa. Rasti i parë ka të bëjë kur letërsia burimore njihet direkt nga gjuha e saj, dhe rasti i dytë kur ajo njihet përmes përkthimit.”³ Në rastin tonë për shkak të mungesës së njohjes së persishtes, shkrimtarët tanë nuk patën një kontakt direkt me rubainë, por indirekt, përmes përkthimeve të Fan Nolit dhe Hafiz Ali Korçës, ndër të cilët më i njohuri mbetet ai i Fan Nolit. Përkthimi në këtë rast luan rolin e ndërmjetësit për një bashkëveprim ndërmjet dy letërsive, letërsisë persiane (si letërsi burimore) dhe asaj shqipe (si letërsi target). Krahësrolit që ka luajtur përkthimi në huazimin e rubaisë nga shkrimtarët shqiptarë të ditëve të sotme, kemi parasysh edhe faktin se kjo teknikë poetike me burim persian është futur dhe mishëruar në poezinë shqipe, përmes përvetësimit. Duke u përvetësuar rubaia është bërë pjesë e repertorit tonë letrar, pavarësisht se i përket një repertori të huaj.

Kjo lidhet edhe me vetë nevojat që ka një letërsi në zhvillim për të përthithur modele apo zhanre të ndryshme nga letërsi të tjera. Mjafton t’i referohemi sërish studiuesit Zohar, kur thotë se “përzgjedhja e elementëve (kemi parasysh, modele, zhanre, etj.) bëhet në pajtim me interesat dhe strukturën e letërsisë target. Elementët nuk transplatohen mekanikisht nga letërsia burimore në letërsinë target, por janë ‘nevojat’ që përcaktojnë dhe prijnë përzgjedhjen”.⁴ Në këtë kontekst, lirshëm mund të themi, se rubaia për poetin Habib Skënderi është forma poetike që i përgjigjet më së miri shpirtit të tij poetik, por edhe mendimeve të tij filozofike. Për ta kuptuar në thelb rubainë, do t’i referohemi disa përkufizimeve që studiues të ndryshëm kanë dhënë lidhur me të. Sipas studiuesit Gibb, Elias John Wilkinson, “rubaia (në shumës ruba’ijjat-ruba’iyyat) ose “katren” është një poemë e shkurtër me katër vargje, ku vargu i parë, i dytë dhe i katërt rimojnë njëri me tjetrin, ndërsa vargu i tretë është i bardhë (ose i zbrazët). Rima e dy vargjeve të para që duket sikur humbet në shfaqjen e rimës së tretë, rikthehet në vargun e katërt, dhe e mbyll poemën e vogël, duke na kënaqur estetikisht. Çdo rubaia është unike në vetvete (sillet si një përmbajtje më vete) dhe nuk ka lidhje me asnjë rubaia tjetër në ide dhe përmbajtje. Po sipas Gibb, “rubaia mund të trajtojë çdo subjekt, duke u bërë një model poetik sa më efektiv.”⁵

² I. Zohar, *Polysystem Studies*, Poetics Today, vol XI, Nr 1, Tel Aviv, 1990, f. 54.

³ I. Zohar, *Papers in historical poetics*, Tel Aviv, 1978, f. 47.

⁴ Po aty, f. 51-52.

⁵ E. J. W. Gibb, *A history of Ottoman poetry 1857-1901*, vol I, London Luzac, Toronto, 1900 f. 88-89.

Rubaira në poezinë shqipe

Ndërsa studiuesi italian, Alessandro Bausani e përkufizon kështu: “kuartina klasike që në kuptimin teknik njihet si rubaia (ose katërvargësh) ose dubajt (dyvargësh), apo ndonjëherë si tarane (melodi), identifikohet nga ana metrike me çfarëdo gazali apo kaside, nga dy vargjet e para. Vargu i parë rimon me dy vargjet që kanë të njëjtën rimë me të parën, duke bërë që kuartina të ketë skemën ritmike a-a-b-a. Kuartina u bë instrumenti i shprehjes së mistikëve.”⁶ Po ashtu, Bausani e shenjon rubainë, “si një formë poetike me strukturë trekëndëshe (triangular), në të cilën ideja fillestare shprehet në dy vargjet e para (ose në dy gjysmëvargjet-hemistikë) të poemës, dhe ideja e dytë në vargun e tretë, që zakonisht nuk rimon me dy të parat. Vargu i katërt na kthen te ideja origjinale me një pohim përfundimtar që buron nga ideja e mëparshme.”⁷ “Në vargëzimin arab dhe persian çdo rresht (bajt) i vargut konsiston në një çift simetrik të gjysmëvargjeve (misra-hemistikë). Rubaia ose katreni persian i referohet katër gjysmëvargjeve, që rimojnë sipas skemës aaba dhe aaaa, e cila kjo e dyta përdorej më shumë në periudhat e hershme të letërsisë persiane. Çdo katrenë trajton një temë të vetme, siç është; tema e dashurisë, verës, misticizmit etj.”⁸ “Rubaia mund të quhet edhe epigram, sepse është e shkurtër dhe esenciale, që ngjason në shumë aspekte edhe me poezinë folklorike tradicionale perse të periudhës pre-islamike. Metri i saj është shumë fleksibël në raport me zhanret e tjera poetike.”⁹ Nëse i referohemi burimit të kësaj forme poetike në letërsinë persiane, rubaia është krijim persian, dhe nuk buron nga poezia arabe. Në fillimet e saj, kjo teknikë përdorej për vepra të karakterit fetar, siç janë rubaitë e Abu Said, dhe më pas për vepra të karakterit filozofik, ku veçohen rubairat e Omar Khajamit. Krijimi i parë i rubaisë mban emrin e poetit Rudaki, dhe poetë të tjerë pas tij, si: Sinai, Attari, Rumi etj., kompozuan katrena me subjekte të ndryshme. Për të vërtetuar këto, mjafton të citojmë shembujt e mëposhtëm:

Dhe në vdekça, sosur fryme, nga një mall i përvëlur, A
Në mos nxjerrtë buza jote asnjë afsh të dëshiruar, A
Ulesh shesh midis qilimit, me nënqeshje pëshpërit’ B
“Vdiq i shkreti sepse prej meje fyerjen se pat duruar.”¹⁰ A (Rudaki)
Aristotel ndriçofsh, ngrysesh e hump! A
Qesar çdo fron zaptofsh, përmbysesh, hump! A
Qelqin Xhamshid, kungofsh, thyhesh e hump! A
Bahram u lavdërosh, mbytesh e hump! ¹¹A (Omar Khajami)

⁶ A. Pagliaro, A. Bausani, *La letteratura persiana*, Sansoni-Accademia, Firenze, 1968, f. 319 dhe 326.

⁷ A. Bausani, *Storia della letteratura persiana*, Milan, 1960, f. 531-532.

⁸ S. Cushman, C. Cavanagh, J. Ramazani. P. Rouzer, R. Greene, *Princeton encyclopedia of poetry and poetics*, vol 4, New Jersey, 2012, f. 1227.

⁹ A. Schimmel, *A two colored brocade, the imagery of persian poetry*, University of North Carolina Press, Chapell Hill and London, 1992, f. 28-29.

¹⁰ D. Shaplo, *Antologjia e poezisë persiane*, Fondazione kulturor iranien “Saadi Shiraz”, Tiranë, 2011, f. 64.

Unë s'jam unë e ti s'je ti, po dhe ti veç nuk je unë A
 Dhe megjithëqë, unë jam unë, ti je ti e ti je unë, A
 Jam në vend ku më ke lënë, o moj lulja mbi Hatun B
 I hutuar e s'dalloj dot a jam unë ti, a ti je unë?¹² A (Rumi)
 Pasi i pimë gjithë detet, çudi na vjen si kanë mbetë A
 Ende të thara buzët tona, ashtu si një ranisht'e shkretë! A
 Drejt detit priremi gjithmonë të lagim buzën e zhuritur B
 Posi ranishte buzët tona e det'i gjerë jemi vetë!¹³ A (Attar)

Sikundër pamë më sipër që poetët persianë kanë shkruar rubaira sipas skemave ritmike aaba dhe aaaa, te rubairat e Habib Skënderit gjejmë me shumicë edhe skemat ritmike të katrenit klasik, krahas skemave origjinale të rubaisë, aaba dhe aaaa. Kështu le tu referohemi shembujve të mëposhtëm;

“Gjith'një ka vend, mik, për të vepruar A
 Gjith'një ka rrugë-për të mësuar A
 vëlla, vazhdo; nuk ka një “stop” B
 Veç kur mbyll sytë-themi “Ka mbaruar”¹⁴ A (Rubaira shqiptare, rubaia 11)
 Na thonë se “kjo rrotullohet..” A
 Po mirë, e dimë që rrotullohet A
 Po vetëm për ca, për ca kujtohet A
 Fakir mos sprit, kështu do të veprohet ¹⁵ A (rubaia 263)
 Fundi s'është aty, ku është fundi- ynë A
 Jeta vazhdon gjith'një- është në rrugë B
 Niprit, stërniprit... ecën, ecën, ecën C
 Është pasagjere' që nuk ndalon kurrë.¹⁶ B (rubaia 8)

Skema ritmike e përdorur në rubainë 8 është ajo e katrenit ABCB, që ndryshe quhet katërvargësh me rimë të kryqëzuar. Vargu A dhe C nuk rimojnë njëri me tjetrin, ndërsa vargu i dytë dhe i katërt rimojnë së bashku. Sipas enciklopedisë, Princeton, “ky metër përdoret për baladat, elegjitë dhe për katërvargëshin e tipit heroik (për vepra të karakterit epiko-heroik).”¹⁷

Pastroje vehten vëlla, hesht, mos qaj A
 Atë që dyshon: Hiqe mos e mbaj A
 Kthjelloje kokën, mos bëj kot Pazar B
 Më mirë trok e bosh, se me zarar.¹⁸ B (rubaia 21)

¹¹ O. Khajam, *Rubairat*, Reklama, Tiranë, 2012, f. 29.

¹² Xh. Rumi, *Shkëndija hyjnore, distikë dhe rubai*, Mendimi i lirë, Berat, 1999, f. 35.

¹³ D. Shaplo, *Antologjia e poezisë persiane*, f. 134.

¹⁴ H. Skënderi, *Rubaira shqiptare, pres*, Botimet Kumi, Tiranë, 2013, f. 5.

¹⁵ H. Skënderi, *Rubaira shqiptare, ku po vemi*, Botimet Kumi, Tiranë, 2014, f. 57.

¹⁶ H. Skënderi, *Rubaira shqiptare, pres*, f. 4.

¹⁷ S. Cushman, C. Cavanagh, J. Ramazani. P. Rouzer, R. Greene, *Princeton encyclopedia of poetry and poetics*, f. 1138.

¹⁸ H. Skënderi, *Rubaira shqiptare, pres*, f. 7.

Rubaira në poezinë shqipe

“Në skemën ritmike AABB shohim se balanca e brendshme ose antiteza krijohet përmes kundërvënies së çifteve, AA dhe BB.”¹⁹.

Derën që e ke hapur në të ri A
Mos e mbaj mbyllur sot, në pleqëri B
Shih kush të vjen; ngrehu mik shko dhe ti A
Derisa numërohesh për njeri.²⁰ B (rubaia 48)

Ndërsa në skemën ritmike ABAB, të rubaisë 48 kemi një alternim të rimave femërore me ato mashkullore, ku rima kryesuese A është një rimë femër. “Katreni me këtë skemë rimimi quhet ndryshe edhe katren i hapur.”²¹

Në kulmak, Osojë dhe në Bllatishtë A
Dua të dal, të ngjitem ndonjë ditë B
T’ulem në lumë ku mrizonin dhinë B
Dhe Balon të thërres, t’ia puth turinjtë.²² A (rubaia 154)

Nëse i referohemi enciklopedisë së poezisë dhe poetikës Princeton, “katreni që rimon sipas skemës ABBA quhet ndryshe katren me rimë të mbështjellë, në formë guaske, ose strofë e mbështjellë. Quhet kështu, sepse rima A mbështjell rimën B dhe kjo bën të mundur krijimin e një rime të dendur në mes, e përshtatshme kjo me rimën mbështjellëse A. Kjo është skema e shumë prej katrenave franceze”²³.

Ndërkaq, katrenat që rimojnë sipas skemave: ABCA, ABBA, AAAB, ABCC, ABCD dhe AABC në rubairat e Habib Skënderit, janë përdorur më pak në raport me skemat e lartpërmendura. Kjo shpjegohet me faktin se, përdorim më të gjerë në veprat letrare të autorëve të ndryshëm kanë pasur katrenat me skemat ritmike, AABB, ABAB, ABCB, dhe si të tillë ata kanë gjetur hapësirën e duhur edhe në rubaitë e poetit Skënderi.

Atë që s’kapim gjithë jetën me punë, A
E kapim natën me një të mbyllur sytë! B
Pa zor e pa mundime e zëmë një fill, C
Dhe shtrijmë përmbi dhe, të madhen urë!²⁴ A (rubaia 26)

Falni njerëz, falni sa s’është vonë, A
Nuk kthehet më këtu ai që shkon! B
Kjo botë është mashtruese, na mashtron B
Në botën tjetër balta na mbulon!²⁵ B (rubaia 202)

¹⁹ S. Cushman, C. Cavanagh, J. Ramazani. P. Rouzer, R. Greene, *Princeton encyclopedia of poetry and poetics*, f. 1139.

²⁰ H. Skënderi, *Rubaira shqiptare, ku po vemi*, f. 14.

²¹ A. Cuddon, *The penguin dictionary of literary terms and literary theory*, Penguin group, England, 1999, f. 720.

²² H. Skënderi, *Rubaira shqiptare, ku po vemi*, f. 35.

²³ S. Cushman, C. Cavanagh, J. Ramazani. P. Rouzer, R. Greene, *Princeton encyclopedia of poetry and poetics*, f. 1139.

²⁴ H. Skënderi, *Kur je duke pritur, rubaira*, Botimet Kumi, Tiranë, 2012, f. 8.

²⁵ Po aty, f. 43.

Ka Poradec, që është sot e Lasgushit, A
 Ka Lasgush pa është Poradeci! B
 Të dy i krahasojmë me njëri-tjetrin, C
 Si dritën e diellit lart me universin!²⁶ C (rubaia 410)

Ku banon e vëren një foshnjë që të kollet, A
 Gjithë këtë natë "njomka" jashtë qet zorrët, B
 Përpiku o bir, t'i afrosh një ndihmë C
 Komshies' së vogël që të qetësohet!²⁷ D (rubaia 133)

Nga të "humburit" s'ka pak, ka shumë A
 Që e ndjekin tani-këtë rrugë. A
 Presin prindërit: gjyshes s'i del shpirti B
 Pa ia ndërë nipit të vetë zënë.²⁸ C (rubaia 124)

Vlerat e këtyre rubairave qëndrojnë jo vetëm te tematika, por kryesisht te artikulumit i tyre poetik. Habib Skënderi përdor në frymë popullore përsëritjen në përgjithësi dhe anaforën në veçanti për të theksuar mendimin. Ai zgjedh gjithashtu metafora nga jeta e përditshme (dera, ura etj.), të thjeshta, po të goditura që e shprehin në mënyrë sintetike idenë e tij. Poeti në shtatë librat me rubaira na vizaton realitetin shqiptar me gjithë koloritin e tij. Ai nxjerr në pah vështirësitë dhe plagët e ndryshme sociale me të cilat përballen sot shqiptarët, si lufta për mbijetesë, emigracioni, droga, gjakmarrja etj. Çdo rubaia është një sintezë e gjendjes së tij shpirtërore. Në to përshkruhet gëzimi dhe hidhërimi i jetës, besimi te vlerat morale njerëzore dhe te drejtësia hyjnore. Filozofia e jetës, humanizmi dhe mistika fetare, përbëjnë tre kulmet e botës poetike, të babait të rubairave shqiptare, Habib Skënderit.

Në përfundim, mund të themi se fleksibiliteti, ekspresiviteti dhe mprehtësia që e karakterizon rubainë në formulimin sa më përmbledhës të idesë poetike, e bëjnë atë një nga modelet teknike më të lëvruar nga poetët shqiptarë të ditëve të sotme. Edhe pse është një formë letrare me burim të huaj u përvetësua mjaft mirë nga poetët tanë, duke u bërë edhe pjesë e repertorit tonë letrar. Te rubaia, ata gjetën gjithashtu edhe një model ideal për të trajtuar çdo temë, si; filozofike, erotike dhe të dashurisë universale, tema sociale dhe morale. Kështu ata kanë përtërirë dhe i kanë dhënë ngjyrë bashkëkohore një forme të lashtë. Në analizën që u bëmë disa prej rubairave të poetit Skënderi, pamë një përpjekje të tij për ta sjellë këtë zhanër në mënyrë sa më origjinale në formë dhe përmbajtje, duke na treguar po ashtu edhe ndikimin e madh që ka pasur dhe vazhdon të ketë në poezinë shqipe.

BIBLIOGRAFI

- A. Bausani, *Storia della letteratura persiana*, Milan, 1960, f. 531-532.
 A. Schimmel, *A two colored brocade, the imagery of persian poetry*, University of North Carolina Press, Chapell Hill and London, 1992, f. 28-29.

²⁶ Po aty, f. 84.

²⁷ Po aty, f. 29.

²⁸ Po aty, f. 27.

Rubaira në poezinë shqipe

- A. Pagliaro, A. Bausani, *La letteratura persiana*, Sansoni-Accademia, Firenze, 1968, f. 319, 326.
- D. Shaplo, *Antologjia e poezisë persiane*, Fondacioni kulturor iranien "Saadi Shiraz", Tiranë, 2011, f. 64.
- E. J. W. Gibb, *A history of Ottoman poetry 1857-1901*, vol. I, London Luzac, Toronto, 1900 f. 88-89.
- H. Skënderi, *Kur je duke pritur, rubaira*, Botimet Kumi, Tiranë, 2012, f. 8.
- H. Skënderi, *Rubaira shqiptare, ku po vemi*, Botimet Kumi, Tiranë, 2014, f. 57.
- H. Skënderi, *Rubaira shqiptare, pres*, Botimet Kumi, Tiranë, 2013, f. 5.
- I. Zohar, *Papers in historical poetics*, Tel Aviv, 1978, f. 47.
- I. Zohar, *Polysystem Studies*, Poetics Today, vol XI, Nr 1, Tel Aviv 1990, f. 54.
- J. A. Cuddon, *The penguin dictionary of literary terms and literary theory*, Penguin group, England, 1999, f. 720.
- O. Khajam, *Rubairat*, Reklama, Tiranë, 2012, f. 29.
- S. Cushman, Clare Cavanagh, Jahan Ramazani, Paul Rouzer, Roland Greene, *The Princeton encyclopedia of poetry and poetics*, vol 4, New Jersey 2012, f. 1138-1139.
- Xh. M. Rumi, *Shkëndija hyjnore, distikë dhe rubai*, Mendimi i lirë, Berat, 1999, f. 35.

